



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 01.10.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:42 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 01.10.2019

3. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Duke qenë që të gjithë anëtarët janë të pranishëm, atëherë fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sot më datë 1 tetor 2019. Në fakt, kjo mbledhje u parashikua jashtë radhe, për shkak të një kërkesë të ngutshme, të ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ditën e djeshme më datë 30 shtator 2019. Pra në rendin e ditës është vetëm një çështje “Caktimi i 1 gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës”.

Kalojmë fjalën zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Mirë atëherë, faleminderit!

Kemi përgatitur një relacion “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”, referuar dy kërkesave të paraqitura nga kjo gjykatë, një është e datës 20 shtator 2019 dhe tjetra është e ditës së djeshme (ka ardhur dje pasdite shkresa datë 30 shtator 2019). Në rastin e parë kërkohet caktimi i një gjyqtari në përbërje të trupit gjykues prej 3 gjyqtarësh për gjykimin e një çështjeje penale të themelit. Kurse kërkesa e mbërritur ditën e djeshme, kërkohet po e njëjta gjë (pra caktimin e një gjyqtari po në këtë çështje) por

mundshmëria në këtë rast ka konsistuar në faktin se një nga të pandehurit në atë çështje ka paraqitur kërkesë për “Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit dhe shuarjen e masës së sigurimit të “arrestit në burg””, që referuar Kodit të Procedurës Penale, do duhet të shqyrtohet brenda 48 orëve. Në këto kushte, Komisioni konsideroi që ta paraqesë menjëherë rastin përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke vlerësuar që në këtë rast, zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit është i pamundur për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në skemën e delegimit, ndërkohë që zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm edhe ky është i pazbatueshëm, pasi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk ka pozicion të lirë të përkohshëm. Duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku referuar të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në rast të pranimit të opsionit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon që për 1 çështje penale, atë nr. 1, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në këtë rast, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, zoti {...}, referuar përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Nëse jeni dakord, mund të vazhdojmë të procedojmë me shortin.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, meqenëse të gjithë anëtarët janë dakord, vazhdojmë me procedurën e shortit. Në një enë do të hedhim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për të përzgjedhur njërin prej tyre, i cili do të caktohet për gjykimin e çështjes gjyqësore të themelit dhe njëherazi për çdo kërkesë që është paraqitur brenda këtij procesi gjyqësor.

Atëherë, emrat janë?

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: {...}, dhe...?

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: {...}.

Do të për zgjedhim emrin e njërit prej tyre.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: {...} është gjyqtari i për zgjedhur nga shorti, i cili caktohet për gjykimin e çështjes penale në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk keni gjë, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor